



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS VITI

Numri i lëndës: 2019:144534

Datë: 06.04.2021

Numri i dokumentit: 01667614

C.nr. 206/15

**GJYKATA THEMELORE GJILAN/DEGA NË VITI - Departamenti i Përgjithshëm,** gjyqtari Arben Xheladini, në çështjen kontestimore të paditësve, N.N nga fshati Goshicë dhe N.N nga fshati Sadovinë e Qerkezëve, Komuna e Vitisë, të cilët i përfaqëson Visar Musa, avokat me seli të zyrës në Ferizaj, rr. e “Reçaku” p.n, kundër të paditurës Byroja Kosovare e Sigurimit (BKS), me seli në Prishtinë, rr. “Lidhja e Pejës” p.n., e përfaqësuar nga Diellza Hajdari nga Prishtina, me objekt kontesti kompensimi i dëmit material dhe jo material, vlera e kontestit 13, 180.00 Euro, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor me datë 23.03.2021, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I.** Aprovohet pjesërisht kërkesëpadia e paditësve N.N dhe N.N, kundër të paditurës Byroja Kosovare e Sigurimit (BKS), detyrohet e paditura që paditësve në emër dëmit jo material dhe material, për shkak të aksidentit të datës 07/06/2015, t’ua paguaj shumat si në vijim:

a) Paditësit N.N për dëmin jo material - për dhimbje fizike shumën prej 500 Euro, për frikë shumën prej 450 Euro, ndërsa në emër të dëmit material, t’ia paguaj shumat si në vijim: -ndihma dhe kujdesi nga personi tjetër për 16 ditë, shumën prej 100 Euro, për ushqim të përforcuar për 18 ditë, shumën prej 100 Euro, rehabilitim në vendet klimatike, shumën prej 150 Euro, shpenzime të mjekimit shumën prej 63 Euro, terapi fizikale për 15 ditë shumën prej 105 Euro, të gjitha këto në shumë të përgjithshme prej 1, 468 Euro, me kamatë ligjore prej 8% në vit, e llogaritur nga data e paraqitjes së padisë- 13.06.2015 e deri në pagesën definitive, në afat prej 15 ditësh nga pranimi i këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit.

b) Paditësit N.N për dëmin jo material-për dhimbje fizike shumën prej 800 Euro; shëmtim trupor 950 Euro, për frikë shumën prej 600 Euro, ndërsa në emër të dëmit material, t’ia paguaj shumat si në vijim: -ndihma dhe kujdesi nga personi tjetër për 16 ditë, shumën prej 100 Euro, për ushqim të përforcuar për 18 ditë, shumën prej 100 Euro, rehabilitim në vendet klimatike, shumën prej 150 Euro, dhe shpenzime të mjekimit - barna shumën prej 63 Euro, të gjitha këto në shumë të përgjithshme prej 2, 713 Euro, me kamatë ligjore prej 8% në vit, e llogaritur nga data e paraqitjes së padisë- 22.06.2016 e deri në pagesën definitive, në afat prej 15 ditësh nga pranimi i këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit.

**II.** Detyrohet e paditura që paditësve t’ia kompensojë shpenzimet e procedurës në shumë prej 779.40 Euro.

**III.** Refuzohen si të pa bazuara pjesët tjera të kërkesëpadisë së paditësve, të kërkuara përtej shumave të aprovuara si në pikën I a) dhe b) të dispozitivit të aktgjykimit.

**III.** Detyrohen paditësit që, që në afat prej 15 ditësh, nga pranimi i aktgjykimit, në mënyrë solidare, të paguajnë taksen shtesë për padi në shumë prej 85 Euro.

### **A r s y e t i m**

Paditësit N.N dhe N.N, nëpërmjet përfaqësuesit të tyre me autorizim, në padinë e datës 13.06.2015 respektivisht datë 22.07 2016, dhe gjatë shqyrtimit kryesor kanë kërkuar nga Gjykata, t'ua aprovojë kërkesëpadinë për kompensimin e dëmit material dhe jo material, për shkak të aksidentit të datës 07.06.2015, që kishte ndodhur për shkak të lëshimeve primare të vozitësit të mjetit transportues Traktor Ferguson IMT 539, dhe lëshimeve dytësore të mjetit të udhëtarëve ËV Golf 1J, me targa 05-943 BS, të cilin e në ditën kritike e ka vozitur paditësi N.N, e për pasojë, të dy paditësit kanë pësuar lëndime të lehta trupore.

Për paditësin N.N, ka kërkuar që e paditura të detyrohet t'ia paguaj dëmin jo material- për dhimbje fizike shumen prej 2, 000 Euro; për frikë shumën prej 2, 300 Euro, ndërsa në emër të dëmi material, t'ia paguaj shumat si në vijim: ndihma dhe kujdesi nga personi tjetër për 20 ditë, shumën prej 100 Euro, për ushqim të përforcuar për 20 ditë, shumën prej 100 Euro, rehabilitim në vendet klimatike me përcjellës, shumën prej 150 Euro dhe shpenzime të mjekimit shumën prej 90 Euro, dhe për terapi fizikale për 20 ditë shumën prej 200 Euro, të gjitha këto në shumë të përgjithshme prej 4, 940 Euro. Ndërsa, për paditësin N.N, për dhimbje fizike shumen prej 2, 000 Euro; për shëmtim trupor shumën prej 3, 500 Euro, për frikë shumën prej 2, 300 Euro, ndërsa në emër të dëmi material, t'ia paguaj shumat si në vijim: -ndihma dhe kujdesi nga personi tjetër për 20 ditë, shumën prej 100 Euro, për ushqim të përforcuar për 20 ditë, shumën prej 100 Euro, rehabilitim në vendet klimatike për 15 ditë, shumën prej 150 Euro, dhe shpenzime të mjekimit - barna shumën prej 90 Euro, të gjitha këto në shumë të përgjithshme prej 8, 240 Euro. Gjithashtu, e ka kërkuar kamatën ligjore prej 8 % në vit, për paditësin N.N e llogaritur nga data 13.06.2015, ndërsa për paditësin N.N nga data 22.06.2016, e deri në pagesën definitive.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar të specifikuar; 208 Euro për përpilim të padisë, për dy ekspertiza mjekësore shumën prej 200 Euro, për tri seanca gjyqësore nga 202.80 Euro për secilën dhe për taksë gjyqësore shumën prej 102 Euro, të gjitha në shumë të përgjithshme prej 1, 118.40 Euro.

E paditura në përgjigje padi dhe gjatë shqyrtimit kryesor të lëndës, nuk e ka kundërshtuar bazën juridike të padisë, por vetëm lartësinë e kërkesave për kompensim duke konsideruar që shumat e kërkuara nga paditësit janë të larta në rast se krahasohen me lëndimet e pësuar në aksidentin e datës 07.06.2015.

Me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, si prova materiale të përbashkëta, gjykata i ka administruar dhe vlerësuar këto prova: Raportin e Policisë, të datës 06.07.2015, skica e vendit të ngjarjes, fotot nga vendi i ngjarjes, Ekspetizen e datës 13.02.2017 e punuar nga Eksperti Gazmend Ukshini në procedurën penale P.nr. 389/2015, ndërsa prova materiale për paditësin N.N: Raporti i Emergjencës i Spitalit Regjional në Gjilan, i datës 07.06.2015, Raporti Specialistik i Neurologut, i datës 22.06.2015, Fletëudhëzimi për ekzaminimi radiologjik, i datës 22.06.2015, konstatimi ortopedit, i datës 26.06.2015, raporti mbi tretmanin nga ambulanca për terapi fizikale, i datës 05.09.2015 së bashku me 24 kopuna fiskal në origjilan, raporti specialistik nga neurologu, nr. prot. 539, datë 08.09.2015 së bashku me dy kupona fiskal, raporti nga ambulanca për terapi fizikale, i datës 07.10.2015 së bashku me 10 kupona fiskal, dhe tre kupona fiskal – për blerje të barnave. Ndërsa, për paditësin N.N: Raporti i Emergjencës i Spitalit Regjional në Gjilan, nr. 10717, i datës 07.06.2015, Fletëlëshimi i Spitalit Gjilan-Reperti i Ortopedisë, nr. 11-156, i datës 08.06.2015, raporti i mjekut ortoped nr. 6730, i datës 01.07.2015, raporti i mjekut psikiater, i datës

23.06.2015, raporti i ortopedit, datë 10.06.2015, raporti i oftalmologut, datë 20.05.2015, 12 kupona fiskal dhe pagesat e participimit në vlerë prej 90 Euro, 11 foto kolor Raporti Specialistik i Neurologut, i datës 22.06.2015, Fletëudhëzimi për ekzaminimi radiologjik, i datës 22.06.2015, konstatimi ortopedit, i datës 26.06.2015, raporti mbi tretmanin nga ambulanca për terapi fizikale, i datës 05.09.2015 së bashku me 24 kopuna fiskal në origjilan, raporti specialistik nga neurologu, nr. prot. 539, datë 08.09.2015 së bashku me dy kupona fiskal, raporti nga ambulanca për terapi fizikale, i datës 07.10.2015 së bashku me 10 kupona fiskal, dhe tre kupona fiskal – për blerje të barnave.

Pas vlerësimit të secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, në bazë të nenit 8 të LPK-ës, gjykata erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësve është pjesërisht e bazuar. Me administrimin e provave materiale, gjykata e vërtetoi këtë gjendje faktike:

Me datë 07.06.2015, rreth orës 21:00 në rrugën Gërlicë – Viti, në dalje të fshatit Sadovinë e Jerlive, paditësit kishin pësuar aksident të komunikacionit, ashtu që deri e aktidenti kishte ardhur për shkak të lëshimeve primare të mjetit transportues Traktor Ferguson IMT 539, dhe lëshimeve dytësore të mjetit të udhëtarëve ËV Golf 1J, me targa 05-943 BS, të cilin e në ditën kritike e ka vozitur paditësi N.N, e për pasojë, të dy paditësit kanë pësuar lëndime të lehta trupore, për çka edhe kanë pranuar tretman mjekësor.

Gjatë shqyrtimit të çështjes, në mes të palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestuese baza juridike e kërkesëpadiës, andaj, gjykata u kufizua vetëm në gjykimin e lartësisë kërkesave për kompensim.

Me raportin policor të datës 07.06.2015, gjykata vërtetoi faktin e aksidentit të ndodhur dhe faktin se paditësi N.N kishte qenë vozitës i automjetit Golf ndërsa paditësi N.N kishte qenë pasagjer në këtë automjet. Nga ekspertiza e telekomunikacionit, u vërtetua se aksidenti kishte ndodhur për shkak të lëshimeve primare të vozitësit të mjetit transportues traktor Ferguson, ngjyre e kuqe, i cili nuk kishte pasur regjistrim e as ndriqim sinjalizimi në pjesën e pasme të rimorkios. Nga kjo ekspertizë, u vërtetua se aksidenti kishte ndodhur edhe për shkak të lëshimeve dytësore të paditësit N.N, i cili në ditën kritike kishte vozitur me shpejtësi prej 25 km më shumë se shpejtësia e lejuar. Me raportet e Qendres Emergjente të Spitalit Regjional në Gjilan, u vërtetua se më datë 07.06.2015, paditësit N.N dhe N.N, kishin kërkuar ndihmë mjekësore.

Në këtë çështje kontestimore, sipas propozimit të përfaqësuesit të paditësve, gjykata ka siguruar provën me ekspertizë të mjekut ekspert-psikiatër dhe ekspert-ortoped traumatolog. Ekspertizat e të dy ekspertëve janë hartuar duke u bazuar edhe në raportet mjekësore që janë administruar si prova materiale.

Me konstatimin e datës 04.02.2021, të ekspertit ortoped-traumatolog, Dr. Milazim Haxholli, ka rezultuar se paditësi N.N, në aksidentin e komunikacionit të datës 07.06.2015, ka pësuar ndrydhje në gjoks, në gjurin e majtë, brrylin e djathtë. Plagë prerëse në brrylin e djathtë, që janë shkaktuar nga goditja me mjet të fortë si pasojë e aksidentit në trafik, e të gjitha këto klasifikohen si lëndime të lehta trupore. Dr. Haxholli, në konstatimin e tij ka gjetur se, paditësi N.N për shkak të lëndimeve ka pësuar dhimbje të intensitetit të rëndë që ka zgjatur një ditë e kjo ka ndodhur për shkak të ndrydhjes së indeve, dhimbje të intensitetit të mesëm që ka zgjatur 18 ditë e që ka ndodhur kohë pas kohe gjatë marrjes së terapisë deri në konsolidimin e indeve të buta dhe dhimbje me intensitet të ulët që ende vazhdon. Po ashtu, është konstatuar se paditësi ka pasur nevojë për ndihmë dhe kujdes nga personi i huaj për 16 ditë, për ushqim të përforcuar për 18 ditë dhe rehabiliti, fizio psikik për 15 ditë.

Me konstatimin e datës 04.02.2021, të ekspertit psikiatër Dr. Valdete Alidema-Serreqi, ka rezultuar se paditësi N.N, si pasojë e aksidentit ka pësuar frikë primare, e cila ka zgjatur disa sekonda, e

gjithashtu ka pësuar edhe frikë sekondare, e cila është manifestuar si frikë sekondare e intensitetit të lartë, e cila ka zgjatur 3 ditë, e manifestuar me gjendje akute në stres dhe është përcjellur me ankth dhe shqetësim. Nga ky konstatim po ashtu ka rezultuar se paditësi ka pësuar frikë sekondare të intensitetit të mesëm që ka zgjatur rreth 3 javë, periudhë kjo e manifestuar me ankth, çrregullim të gjumit, dhe pengesa lidhur me kryerjen e rutinës së përditshme. Sipas këtij konstatimi, paditësi ka pësuar edhe frikë sekondare të intensitetit të ulët në kohëzgjatje prej 3 muaj, dhe gjatë kësaj periudhe janë manifestuar simptomat e njëjta, por me intensitet më të ulët, e gjithashtu edhe shqetësime në formë të ankesave somatike që kanë ndikuar edhe në reduktimin e raporteve familjare dhe shoqërore.

Me konstatimin e datës 04.02.2021, të ekspertit ortoped-traumatolog, Dr. Milazim Haxholli, ka rezultuar se paditësi N.N, në aksidentin e komunikacionit të datës 07.06.2015, ka pësuar ndrydhje në kokë, trup, në zogun e këmbës së djathtë, brrylin e djathtë. Plagë prerëse në buzën e sipërme dhe nën syrin ana e djathtë, që janë shkaktuar nga goditja me mjet të fortë si pasojë e aksidentit në trafik, e të gjitha këto klasifikohen si lëndime të lehta trupore. Dr. Haxholli, në konstatimin e tij ka gjetur se, paditësi N.N për shkak të lëndimeve ka pësuar dhimbje të intensitetit të rëndë që ka zgjatur dy ditë e kjo ka ndodhur për shkak të ndrydhjes së indeve të ëkokës, qafës, brrylit, këmbës dhe plagëve në buzë dhe sy; dhimbje të intensitetit të mesëm që ka zgjatur 20 ditë e që ka ndodhur kohë pas kohe gjatë marrjes së terapisë deri në konsolidimin e indeve të buta dhe dhimbje me intensitet të ulët që ende vazhdon. Po ashtu, është konstatuar se paditësi ka pasur shëmtim trupor të shkallës së lehtë për shkak të vrragës në pjesën e buzës së sipërme me gjatësi prej 2-3 cm e gjerësi 1 cm, si dhe vrragës në pjesën e nën syrit të djathtë me diametër 1 cm që është e dukshme tërë kohën. Gjithashtu, është konstatuar se paditësi ka pasur nevojë për ndihmë dhe kujdes nga personi i huaj për 16 ditë, për ushqim të përforcuar për 18 ditë dhe rehabilitim, fizio psikik për 15 ditë.

Me konstatimin e datës 04.02.2021, të ekspertit psikiatër Dr. Valdete Alidema-Serreqi, ka rezultuar se paditësi N.N, si pasojë e aksidentit ka pësuar frikë primare, e cila ka zgjatur disa sekonda, e gjithashtu ka pësuar edhe frikë sekondare, e cila është manifestuar si frikë sekondare e intensitetit të lartë, e cila ka zgjatur 2 ditë, e manifestuar me gjendje akute në stres dhe është përcjellur me ankth dhe shqetësim. Nga ky konstatim po ashtu ka rezultuar se paditësi ka pësuar frikë sekondare të intensitetit të mesëm që ka zgjatur rreth 4 javë, periudhë kjo e manifestuar me ankth, çrregullim të gjumit, dhe pengesa lidhur me kryerjen e rutinës së përditshme. Sipas këtij konstatimi, paditësi ka pësuar edhe frikë sekondare të intensitetit të ulët në kohëzgjatje prej 3 muaj, dhe gjatë kësaj periudhe janë manifestuar simptomat e njëjta, por me intensitet më të ulët, e gjithashtu edhe shqetësime në formë të ankesave somatike që kanë ndikuar edhe në reduktimin e raporteve familjare dhe shoqërore.

Me rastin e administrimit të provave, përfaqësuesja e të paditurës nuk e ka pasur asnjë vërejtje në provat e administruara materiale, e gjithashtu nuk i ka kundërshtuar konstatimet e ekspertit ortoped-traumatolog dhe ekspertit psikiatër.

Meqenëse aksidenti ka ndodhur në shtator të vitit 2015, si ligj material gjykata e zbatoi Ligjin e Marrëdhënieve të Detyrimeve të vitit 2012, të cilit tani e tutje do t'i referohet me shkurtesën LMD, si dhe Ligjin për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia Ligji nr. 04/L-018, të cilit tani e tutje do t'i referohet si LSDA.

Meqenëse shkaktari i aksidentit nuk ka pasur regjistrim, përgjegjësia e të paditurës për dëshmipërblimin e dëmit rrjedh nga neni 18.1 të LSDA sipas të cilit "Personi i dëmtuar të cilit i është shkaktuar dëmi brenda territorit të Republikës së Kosovës nga një mjet motorik, pronari i të cilit nuk është i mbuluar nga sigurimi i autopërgjegjësive, ka të drejtë të kërkojë dëshmipërblimin e

dëmit nga Byroja. Ndërsa, par. 2 i të njejtit nen përcakton “Në rast dëmi të shkaktuar nga mjeti motorik sipas paragrafit 1. të këtij neni, Byroja garanton për detyrime në kuadër të limiteve të përcaktuara sipas nenit 13 të këtij ligji”. Ndërsa në nenin 10, ky ligj ka përcaktuar mënyrën e kompensimit, sipas të cilit “Kompensimi i dëmit material dhe jomaterial bëhet në pajtim me dispozitat e Ligjit për marrëdhëniet e detyrimeve”.

Pasi që në shkaktimin e aksidentit kanë kontribuar të dy pjesëmarrësit, gjykata ka zbatuar dispozitat ligjore të LMD sipas përgjegjësisë së ndarë.

Me nenin 176 të LMD është përcaktuar përgjegjësia e ndarë, sipas të cilit, në par 1 parashihet “I dëmtuari i cili ka kontribuar që dëmi të krijohet ose të jetë më i madh se sa përndryshe do të ishte, ka të drejtë vetëm në shpërblimin përpjesëtimisht të pakësuar. Ndërsa par. 3 parasheh “Kur është e pamundur të vërtetohet se cila pjesë e dëmit rezulton nga veprimi i të dëmtuarit, gjykata do të gjykojë shpërblimin duke pasur parasysh rrethanat e rastit. Neni 189 i LMD përcakton “Dispozitat për përgjegjësinë e ndarë dhe për zvogëlimin e shpërblimit që vlejné për dëmin material përshtatshëmrisht zbatohen edhe për dëmin jomaterial. Sipas dispozitave ligjore të LMD, në këto raste të dëmtuarit i takon e drejta në kompensim të dëmit material neni 179 i LMD dhe jo material neni 183 i LMD, e që zakonisht kompensimi bëhet në të holla, ndërsa vëllimi i kompensimit bëhet varësisht nga rrethanat e rastit konkret.

Meqenëse nga provat e administruara u mbështet baza ligjore e kërkesëpadisë e cila nuk ishte kontestuese për të paditurën, gjykata e gjeti si pjesërisht të bazuar kërkesëpadinë e paditësve.

Gjykata e aprovoi pjesërisht kërkesën e paditësve për kompensimin e dëmit jo material, dhe për këtë u bazua në disa faktorë. Fillimisht, gjykata mori parasysh faktin se aksidenti kishte ndodhur për shkak të lëshimeve primare të mjetit transportues traktor Ferguson, i cili kishte qarkulluar pa regjistrim dhe pa shenja sinjalizuese në pjesën e pasme të rimorkios, për çka edhe kishte ndodhur aksidenti. Po ashtu, gjykata mori për bazë edhe faktin se aksidenti kishte ndodhur me kontributin e vozitësit të automjetit Golf - paditësit N.N, i cili kishte vozitur në aksin rrugor me shpejtësi prej 25 km më shumë se sa shpejtësia e lejuar në atë rrugë.

Për këtë arsye, me rastin e gjykimit të kërkesave për paditësin N.N, gjykata mori për bazë kontributin e tij në shkaktimin e këtij aksidenti e që ishte me ndikim në lartësinë e të gjitha kërkesave të tij. Andaj, për këtë paditës, gjykata i aprovoi pjesërisht kërkesat për dëmin jo material - dhimbje dhimbje fizike shumë prej 500 Euro, për frikë shumë prej 450 Euro, ndërsa në emër të dëmit material -ndihma dhe kujdesi nga personi tjetër për 16 ditë, shumë prej 100 Euro, për ushqim të përforcuar për 18 ditë, shumë prej 100 Euro, rehabilitim në vendet klimatike për 15 ditë, shumë prej 150 Euro, shpenzime të mjekimit shumë prej 63 Euro dhe shpenzimet për terapi fizikale për 15 ditë, shumë prej 105 Euro, të gjitha këto në shumë të përgjithshme prej 1, 468 Euro. Konstatimit të ekspertëve gjykata ua fali plotësisht besimin, në të cilat edhe e paditura nuk pati vërejtje, e për këtë arsye gjykata konsideron se shumatat e gjykuara për të dëmin jo material dhe material, janë në përputhje me natyrën e lëndimeve dhe dhimbjeve të pësuar, dhe paraqesin satifikacion të drejtë për tejkalimin me më lehtësi të pasojave të kësaj forme të dëmit të shkaktuar. Lidhur me shpenzimet e mjekimit, për këtë paditës u paraqiten kupona fiskal në lartësi prej 90 Euro, ndërsa gjykata e aprovoi shumë prej 63 Euro sipas përgjegjësisë së ndarë, dhe për këtë arsye edhe e zvogëloi shumë e kërkesës për kompensim. E njëjta formulë u përdor edhe kompensimit të shpenzimeve për terapi fizikale, ashtu që nga 20 kupon fiskal të prezentuar, për kompensim u aprovua shuma prej 105 Euro. Ndërsa, sa i përket kompensimit të dëmit material – ndihma/kujdesi nga personi tjetër, ushqim të përforcuar, gjykata i aprovoi kërkesat në tërësi pasi që i gjeti të bazuara dhe këtë e bëri duke u mbështetur në konstatimin e ekspertit ortoped-traumatolog, ndërsa, shuma prej 100 Euro për 16 ditë për ndihmë dhe kujdes nga personi tjetër,

dhe shuma prej 100 Euro për ushqim të përforcuar, konsiderohet se janë adekuate pasi që, në këtë rast, me ekspertizë mjekësore u konstatua se paditësi ka pasur nevojë për ndihmë dhe kujdes nga personi tjetër, e gjithashtu edhe për ushqim të përforcuar, ndërsa, shumat e aprovuara rezultojnë të jenë në përputhje me kontributin e paditësit në shkaktimin e aksidentit.

Ndërsa, sa i përket paditësit N.N, përveç ndarjes së përgjegjësisë, për këtë paditës gjykata e mori për bazë faktin se kishte qenë pasagjer dhe për këtë arsye, shumat e aprovuar për të lehtësisht dallojnë në raport me paditësin N.N. Sidoqoftë, edhe për paditësin N.N, gjykata i aprovoi pjesërisht kërkesat e tij, edhe atë për dhimbje fizike shumen prej 800 Euro; për shëmtim trupor 950 Euro, për frikë shumë prej 600 Euro, ndërsa në emër të dëmi material -ndihma dhe kujdesi nga personi tjetër për 16 ditë, shumë prej 100 Euro, për ushqim të përforcuar për 18 ditë, shumë prej 100 Euro, rehabilitim në vendet klimatike, shumë prej 150 Euro dhe shpenzime të mjekimit - barna shumë prej 63 Euro, të gjitha këto në shumë të përgjithshme prej 2, 713 Euro. Konstatimit të ekspertëve gjykata ua fali plotësisht besimin, në të cilat edhe e paditura nuk pati vërejtje, e për këtë arsye gjykata konsideron se shumat e gjykuara për dëmin jo material dhe material, janë në përputhje me natyrën e lëndimeve dhe dhimbjeve të pësuar, dhe paraqesin satisfkacion të drejtë për tejkalimin me më lehtësi të pasojave të kësaj forme të dëmit të shkaktuar. Sa i përket kompensimit për shëmtim trupor, edhe pse është i paraqitur në formë të lehtë, gjykata mori për bazë moshën e re të paditësit N.N e gjithashtu faktin se shenjat janë në vende të dukshme. Lidhur me shpenzimet e mjekimit, për këtë paditës u paraqiten kupona fiskal në lartësi prej 90 Euro, ndërsa gjykata e aprovoi shumë prej 63 Euro sipas formulës së njëjtë për përgjegjësinë e ndarë sikur me rastin e vendosjes për paditësin N.N. Ndërsa, sa i përket kompensimit të dëmit material – ndihma/kujdesi nga personi tjetër, ushqim të përforcuar dhe shërim klimaterik, gjykata i aprovoi kërkesat në tërësi pasi që i gjeti të bazuara dhe këtë e bëri duke u mbështetur në konstatimin e ekspertit ortoped-traumatolog, ndërsa, shuma prej 100 Euro për ndihmë dhe kujdes nga personi tjetër, dhe shuma prej 100 Euro për ushqim të përforcuar, janë adekuate pasi që, në këtë rast, me ekspertizë mjekësore u konstatua se paditësi ka pasur nevojë për ndihmë dhe kujdes nga personi tjetër, e gjithashtu edhe për ushqim të përforcuar, ndërsa, shumat e aprovuara rezultojnë të jenë në përputhje sipas formulës së përgjegjësisë së ndarë.

Gjykata vlerëson se shumat e aprovuara janë adekuate në raport me dëmet jo materiale të paditësve, e gjithashtu edhe me kriteret dhe qëllimin që ligjdhënësi e ka përcaktuar në nenin 183 të LMD, duke konsideruar se këto shuma e arrijnë qëllimin e satisfaksionit në mënyrë që të dëmtuarit-paditësit t'i përballojnë më lehtë dëmet jo materiale të pësuar. Me paragrafin 2 të nenit 183 të LMD përcaktohet se “Me rastin e vendosjes për kërkesën për shpërblimin e dëmit jo material, si dhe për lartësinë e shpërblimit të tij, gjykata do të kujdeset për rëndësinë e cenimit të së mirës dhe të qëllimit të cilit i shërben ky shpërblim, por edhe për atë, se me te mos të favorizohen synimet që nuk janë në pajtim me natyrën e saj dhe me qëllimin shoqëror”. Sipas kësaj dispozite ligjore, kompensimi duhet të jetë adekuat me natyrën e lëndimit, intensitetin dhe kohëzgjatjen e dhimbjeve të përjetuara, frikës së të dëmtuarve, në mënyrë që kompensimi të shërbejë për tejkalimin më me lehtësi të pasojave të dëmit që, paditësit në këtë rast, i kanë pësuar në aksident të komunikacionit, dhe për aq sa është e mundur kompensimi të paraqes një satisfaksion dhe jo ndonjë përfitim nga të dëmtuarit-paditësit në këtë rast.

Gjykata i refuzoi shumat e kërkuara përtej shumës së gjykuar pasi që konsideroi se shumat e aprovuara paraqesin një kompensim të drejtë dhe të ligjshëm të dëmeve që paditësit i kanë pësuar në aksidentin e komunikacionit, e të cilat paraqesin një satisfaksion të drejtë për të tejkualuar më lehtë pasojat e shkaktuara nga aksidenti. Për paditësin N.N, gjykata pati parasysh faktin se i njejtë ka kontribuar në shkaktimin e aksidentit, andaj, edhe lartësia e kompensimit të të gjitha kërkesave të tij, u bazua në formulën e përgjegjësisë së ndarë. Ndërsa, për paditësin N.N, gjykata e mori për bazë edhe faktin tjetër se, i njejtë si pasagjer, ka pësuar nga veprimet e ngasësve të mjeteve në

komunikacion, dhe për këtë lartësia e kërkesave të aprovuara është lehtësisht më e lartë se sa për paditësin N.N. Gjykata e ka parasysh, se në parim, dëmet jo materiale nuk mund të kompensohen me të holla, megjithatë, duke pasur parasysh natyrën e lëndimeve, pasojat, kohëzgjatjen, moshën e të dëmtuarve, me shumatat e aprovuara, paditësit më lehtë do t'i tejkalojnë pasojat e shkaktuara nga aksidenti.

Lidhur me kamatën, gjykata vendosi në bazë të nenit 382 të LMD, dhe e detyroi të paditurën që paditësve t'ia kompensoj shumatat si në pikën I të dispozitivit me kamatë ligjore prej 8% në vit e llogaritur nga data e paraqitjes së padisë respektivisht parashtresës për zgjerim të padisë, e deri në pagesën definitive.

Sa i përket shpenzimeve të procedurës, gjykata vendosi duke u bazuar në nenin 452.2 të LPK-së, i cili përcakton "Po që se paditësi vetëm pjesërisht ka sukses në procesin gjyqësor, atëherë gjykata mundet, duke marrë parasysh suksesin e arritur, të caktojë që secila palë t'i bartë shpenzimet e veta apo që njëra palë t'ia shpërblej tjetrës, dhe ndërhyrësit që i është bashkuar, pjesën proporcionale të shpenzimeve". Në këtë rast, gjykata vlerësoi se paditësve duhet t'i kompensohen shpenzimet e domosdoshme të procedurës, ndërsa fakti se shpenzimet nuk u aprovuan në tërësi ishte i përzier: me lartësinë e kërkesave të aprovuara dhe me atë se shumatat e kërkuara për disa aktivitete të përfaqësuesit të paditësve, nuk ishin në harmoni me rregulloren për tarifën e avokatëve e gjithashtu se kishte veprime që u konsideruan jo të domosdoshme. Për këtë arsye, e paditura u detyrua që paditësve t'ia kompensojë shpenzimet e procedurës si në vijim: 104 Euro për padi, dhe 52 Euro për parashtresë për zgjerim të padisë (50 % e shumës së padisë për paditësin e dytë) respektivisht shumën prej 156 Euro, për dy ekspertiza mjekësore shumën prej 200 Euro<sup>1</sup>, për tri seanca gjyqësore nga 202.80 Euro për seancë respektivisht shumën prej 608.40 Euro, dhe 15 Euro për taksë gjyqësore, të gjitha në shumë prej 779.40 Euro, duke u bazuar në UA për unifikimin e taksave gjyqësore, dhe rregulloren e OAK. Lidhur me shpenzimet e përfaqësimit për seanca gjyqësore, gjykata vendosi duke u bazuar në TA, sipas të cilës, për paditësin e dytë, avokatit i takon 50 % e shumës për seancë, që në këtë rast shpërblimi i avokatit për një seancë gjyqësore është 135 Euro ndërsa për paditësin e dytë shuma prej 67.60 Euro, që në total shpenzimet e përfaqësimit në tri seanca gjyqësore u aprovuan ashtu siç u kërkuar nga avokati. Gjykata nuk e aprovoi kërkesën për kompensimin e shumës prej 150 Euro për përpilim të precizimit për shkak se e gjeti si jo të domosdoshëm për t'u bërë me shkrim, duke pasur parasysh faktin se në këtë parashtresë nuk është dhënë ndonjë arsyetim për shumatat e kërkuara, e që do të arsyetohej kërkesa për kompensimin e kësaj parashtrese. Për taksë gjyqësore, gjykata e aprovoi vetëm shumën prej 15 euro për shkak se, sipas shkresave të lëndës, me rastin e paraqitjes së padisë vetëm kjo shumë është paguar.

Lidhur me taksën gjyqësore për padi, duke u bazuar në nenin 6.2 të UA.Nr.01/2017 për unifikimin e taksave gjyqësore, gjykata i obligoi paditësit që, në mënyrë solidare të paguajnë shumën shtesë prej 85 Euro, duke u bazuar në nenin 12.1 të udhëzimit të lartcekur, sipas të cilit, për kërkesat në para vlera e të cilave e tejkalon shumën prej 10, 001.00, taksa për padi është 100 Euro. Meqenëse vlera e kërkesave të paditësve ka qenë 13, 180.00 Euro, ndërsa, sipas shkresave të lëndës, për taksë gjyqësore është paguar shuma prej 15 euro, paditësit u detyruan që të paguajnë shumën shtesë prej 85 Euro.

Gjykata administroi edhe prova të tjera materiale, por të njëjtat nuk i arsyetoi, pasi që ishin pa ndikim në vendosjen e çështjes.

<sup>1</sup> Me aktvendim të veçantë gjykata do të urdhroj arken e kësaj gjykate që paditësve t'ua kthejë shumën prej 100 Euro për shkak se, sipas depozitës civile të gjykaës, për shpërblimin për ekspertë e kanë deponuar shumën prej 300 Euro, ndërsa ekspertët i kanë kërkuar secili nga 100 Euro.

Nga të lartcekurat, e duke u bazuar në nenin 176, 179, 183 dhe 189 të LMD, nenin 18 të LSDA, dhe nenin 2 lidhur me nenin 142 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-DEGA NË VITI**  
**C.nr. 206/15, datë 23.03.2021**

**Gjyqtari,**

Arben Xheladini

**Këshillë Juridike:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në Gjykatën Apelit të Kosovës në Prishtinë, në afatin prej 15 ditëve, pas ditës së pranimit. Ankesa, në kopje të mjaftueshme, dorëzohet në këtë gjykatë.